



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°15/2022

Hagë, 21/04/2022

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në çështjen *Salih Mustafa*, gjatë gjithë kësaj jave janë mbajtur seanca gjyqësore. Deri tani, Mbrojtja e z. Mustafa ka thirrur 12 dëshmitarë për të dëshmuar. Pjesa më e madhe e dëshmive janë dhënë në seancë publike.

Seanca vijuese në këtë çështje është planifikuar për nesër, të premten 22 prill, në orën 9:30.

Në çështjen *Pjetër Shala*, Kryetare Trendafilova më 19 prill 2022 caktoi një Panel të Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi kërkesën referuese në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave themelore të akuzuarit, të dorëzuar nga Mbrojtja e z. Shala më 14 prill 2022. Paneli i Gjykatës Kushtetuese përbëhet nga gjykatësit Vidar Stensland, Roumen Nenkov dhe Romina Inkuti.

Gjithashtu në çështjen e z. Shala, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjatë konferencës për ecurinë e çështjes që u mbajt më 14 prill, nxori një numër urdhrash gojorë, midis të cilëve edhe në lidhje me kalendarin procedural në këtë çështje gjyqësore. Gjykatësi i Procedurës Paraprake, mes të tjerash, urdhëroi ZPS-në që brenda 27 majit 2022, të përmbushë të gjitha detyrimet e veta në lidhje me nxjerrjen e materialeve të fazës paraprake.

Më tej, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Mbrojtjen të dorëzojë dosjen paraprake brenda datës 15 gusht 2022, në rast se vendosin të dorëzojnë një të tillë. Dosja paraprake përmban një përshkrim të përgjithshëm të mbrojtjes së të akuzuarit, akuzat dhe pikat që i akuzuari kundërshton dhe listën e dëshmitarëve të mundshëm, pa cenuar ndonjë ndryshim të mëvonshëm.





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°15/2022

Hagë, 21/04/2022

Gjykatësi i Procedurës Paraprake, e përfundoi urdhrin e tij gojor duke caktuar si datë të re paraprake 31 gushtin 2022 për kalimin e dosjes së çështjes gjyqësore te trupi gjykues.

**Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

